



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 23.2.2024

Lënda: Parashtrime të Komisionerit Publik, në seancën gjyqësore të datës 23.2.2024, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 442, datë 14.9.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Juljan Çafka

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 i aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në vijim të njoftimit për depozitimin pranë tij të akteve të kërkuara për efekt të hetimit gjyqësor në gjykimin konkret, pas konsultimit paraprak me dokumentacionin voluminoz, me shkresën nr. ***/** prot., datë **.2.2024, regjistruar në IKP me nr. **/** prot., datë **.2.2024, ka përcjellë shkresën e gjyqtarit kryesues të trupit gjykues të çështjes (JR) nr.72/2021, datë 23.11.2021, me atë të së cilës janë përcjellë kopje të disa prej akteve të fashikujve penalë, të dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastër.

Pas shqyrtimit të akteve të administruara, në raport me shkaqet e ankimit, Komisioneri Publik, parashtron si në vijim:

1. *Në lidhje me procedimin penal me nr. ***, datë **.6.2017, për kryerjen e veprës penale “Shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në ankimin e Komisionerit Publik, të datës 11.11.2021, është parashtruar nevoja e hetimit lidhur me këtë procedim penal për sa i përket: (i) verifikimit të shkaqeve që kanë sjellë kohëzgjatjen e hetimit nga momenti i regjistrimit të procedimit penal nr. ***, datë **.6.2017, deri në paraqitjen e kërkesës për pushimin e procedimit penal, datë **.11.2020, referuar nenit 327 të K. Pr. P.; (ii) verifikimit të subjekteve, të cilëve u atribuohet vepra penale, regjistrimi i tyre referuar nenit 287 të K. Pr. P. dhe zbatimi eventual i dispozitës së nenit 75/a, lidhur me nenin 80, të Kodit të Procedurës Penale, në përcaktimin e kompetencës lëndore, në hetimin e procedimit penal, referuar edhe detyrave të lëna nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastër, në vendimin nr. **, datë **.2.2021.*

1.1 Referuar akteve të administruara lidhur me procedimin penal nr. ***, datë **.6.2017, rezulton se në aktin procedural të datës **.10.2020 me objekt: “*Kërkesë për pushimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2017*”, konstatohet se ky procedim penal është regjistruar më datë **.6.2017, për veprën penale “*Shpërdorim i detyrës*” i parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Ky procedim penal është regjistruar mbi bazën e materialit kallëzues të Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër¹, ku kjo e fundit e ka referuar nevojën e procedimit për një veprë me rrezikshmëri më të ulët, konkretisht për veprën penale “*Ndërtim i paligjshëm*”, të parashikuar nga neni 199/a të Kodit Penal, bazuar në kallëzimin e shtetasit ***.***. Ky shtetas, para Oficerit të Policisë Gjyqësore në Drejtorinë e Policisë Gjirokastër, më datë **.06.2017, sërish ka kallëzuar verbalisht kryerjen e veprës penale, ku pretendon se në lidhje me ndërtimin e tregut industrial në lagjen “**** **”, Gjirokastër, po kryhen veprime të parregullta nga shtetasi ***. ***. dhe Bashkia Gjirokastër. Rezultoni se për këtë procedim penal nuk janë regjistruar emrat e personave që u atribuohet kryerja e veprës penale.

1.1.1 Veprimet hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se janë kryer në kuadër të administrimit të akteve të marra nga kallëzuesi ***. ***, si dhe ato të këqyrura dhe marra në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gjirokastër, Këshillin Bashkiak Gjirokastër dhe Bashkinë Gjirokastër. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka vendosur kryerjen e një akti tekniko-vlerësues, si dhe ekspertimit topografik, duke caktuar ekspertët përkatës.

1.1.2 Nga vlerësimi i tërësisë së akteve hetimore të këtij procedimi penal, subjekti i rivlerësimit ka arritur në përfundimin se nuk ndodhemi përpara kryerjes së veprës penale “*Shpërdorim detyrë*”, e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, duke kërkuar nga Gjykata miratimin e pushimit të procedimit penal.

1.1.3 Gjykata së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastër me vendimin nr. ***, datë **.2.2021, ka vendosur mosmiratimin e kërkesës dhe kthimin e akteve prokurorit për vazhdimin e hetimeve.

1.1.4 Në vijim të hetimeve, rezultoni se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur sërish kërkesë për pushimin e procedimit penal me nr. ***, të vitit 2017, dhe Gjykata së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastër, me vendimin nr. ***, datë **.7.2022, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe pushimin e procedimit penal, duke u mbështetur në argumentimin e kërkesës së paraqitur nga ana e subjektit të rivlerësimit. Nuk kemi konstatuar në aktet e administruara, shënime lidhur me statusin e fuqisë së kësaj vendimmarrje.

1.2 Nga sa më lart, në gjendjen që janë aktet, rezultoni se në hetimin e këtij procedimi penal, të regjistruar më datë **.6.2017 dhe dërguar kërkesa e parë për pushimin e procedimit penal më datë **.10.2020, subjekti i rivlerësimit ka kryer një sërë veprimesh hetimore, por duket se mbeten për t’u vlerësuar shkaqet eventuale që do të pretendohen edhe në këtë gjykim lidhur me një kohëzgjatje të tillë në rastin konkret.

1.3 Lidhur me shkakun ankimor në lidhje me zbatimin e dispozitave penale të parashikuara nga nenet 75/a, 80 dhe 287 të Kodit të Procedurës Penale, në gjendjen që janë aktet, edhe pas miratimit gjyqësor të disponimit për pushimin në këtë procedim penal, për sa kohë nuk ka gjetur zbatim neni 287 i Kodit të Procedurës Penale për regjistrimin e emrit të

¹ Shkresa me nr. *** prot., datë **.6.2017 dhe shkresa me nr.*** prot., datë **.6.2017.

personit të cilit i atribuohet vepra penale, nuk kanë zbatim dispozitat e neneve 75/a, 80 të Kodit të Procedurës Penale.

2. Në lidhje me ekzekutimin e vendimeve penale në ngarkim të shtetasit *** ***, në ankimin e Komisionerit Publik të datës 11.11.2021, është parashtruar nevoja e hetimit të mëtijshëm në drejtim të verifikimit nëse veprimet procedurale janë kryer nga subjekti i rivlerësimit, dhe nëse është zbatuar në mënyrë korrekte legjislacioni në fuqi për ekzekutimin e vendimeve penale, konkretisht për: (1) vendimin penal nr.***, datë **.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë, lënë në fuqi nga vendimi nr. ***, datë **.3.2018, i Gjykatës së Apelit Gjyqësor, dhe (2) vendimin nr.***, datë **.6.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

2.1 Referuar akteve të administruara lidhur me vendimin penal nr. ***, datë **.10.2017, rezulton se Gjykata së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë ka vendosur deklarinim fajtor të të pandehurit *** *** për veprën penale të “*Pengimit për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës*” dhe në bazë të nenit 320 të Kodit Penal, dënimin e tij me 4 muaj burgim. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjyqësor me vendimin nr. ***, datë **.3.2018. Konstatohet se në aktin e administruar “*vendimin penal gjyqësor nr. ***, datë **.10.2017*”, rezulton një vulë datare/protokoll me këtë mbishkrim “*Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë nr. -_, prot., dt **.05.2018*”.

2.1.1 Subjekti i rivlerësimit, në të njëjtën datë, **.5.2018, ka lëshuar urdhrin nr.***, datë **.5.2018, “*Për ekzekutimin e vendimit penal të gjykatës*”, në bazë të ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998, “*Për ekzekutimin e vendimeve penale*” dhe kërkesave të neneve 462 – 467 të Kodit të Procedurës Penale, ka urdhëruar ekzekutimin e vendimit nr. ***, datë **.10.2017, të së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastrë dhe ka ngarkuar për ekzekutimin e tij shërbimet e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Gjyqësore, përcjellë kësaj drejtorie me shkresën nr. *** prot., /xh.**, datë **.5.2018, të drejtuesit të Prokurorisë.

2.1.2 Drejtoria Vendore e Policisë Gjyqësore, me shkresën nr. *** prot., datë **.6.2019, me lëndë: “*Dërgohen materialet për shpalljen në kërkim ndërkombëtar*”, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë, ka dërguar materialet përkatëse për shpallje në kërkim ndërkombëtar të shtetasit *** ***, nga ku rezulton se nga kërkimet e bëra nuk është bërë e mundur gjetja e shtetasit *** *** brenda territorit kombëtar, si dhe nga informacionet që disponohen, ky shtetas ndodhet jashtë shtetit, në Greqi.

2.1.3 Subjekti i rivlerësimit, në datën **.6.2019, ka lëshuar “*Urdhrin për kërkim ndërkombëtar*”, për të dënuarin *** ***.

2.2 Referuar akteve të administruara lidhur me vendimin penal nr.***, datë **.6.2019, rezulton se Gjykata së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastrë, me vendimin me objekt “*Caktimin e masës së sigurimit*”, ka vendosur: Caktimin e masës së sigurimit “*arrest në burg*”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale të shtetasit nën hetim *** ***, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “*Mashtrimet*”, vepër kjo e parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal.

2.2.1 Subjekti i rivlerësimit, me urdhrin datë **.6.2019, “*Për ekzekutimin e vendimit penal të gjykatës*”, në bazë të nenit 246 të të Kodit të Procedurës Penale, ka urdhëruar ekzekutimin

e vendimit penal nr. ***, datë **.6.2019, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastrë, duke e shpallur këtë person në kërkim kombëtar dhe ka ngarkuar për ekzekutimin e tij shërbimet e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastrë.

2.2.2 Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë, me shkresën nr.*** prot., datë **.11.2019, me lëndë: “Njoftim për shpalljen në kërkim ndërkombëtar”, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, ka informuar se nga kërkimet e bëra nuk është bërë e mundur gjetja e shtetasit *** ** brenda territorit kombëtar, si dhe nga informacionet që disponohen, ky shtetas ndodhet jashtë shtetit shqiptar.

2.2.3 Subjekti i rivlerësimit, në datën **.12.2019, ka lëshuar “Urdhrin për kërkim ndërkombëtar”, për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimit për caktimin e masës së sigurimit në ngarkim të shtetasit *** **.

2.3 Nga sa më lart, në gjendjen që janë aktet, nuk konstatohen problematika në veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit për procedurën e ekzekutimit të këtyre dy vendimeve penale.

3. Në lidhje me procedimin penal nr.*/* i vitit 2017, në ngarkim të shtetasit *** **, në ankimin e Komisionerit Publik, të datës 11.11.2021, është parashtruar nevoja e hetimit të mëtejshëm në drejtim të verifikimit, nëse është subjekti i rivlerësimit, prokurori i çështjes të procedimit penal nr. ***/*, viti 2017, dhe respektimit të afateve të hetimit të saj, në kuptim të nenit 323 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale.**

3.1 Referuar akteve të administruara lidhur me procedimin penal nr.***/*, i vitit 2017, rezulton se, në datën **.7.2017, është regjistruar procedimi penal për kallëzimin penal nr. ***, të vitit 2017, për veprën penale “Mashtrimi”, e parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit *** **, nga prokurori ***. **.

3.1.1 Subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës **.6.2019, “Për ndarjen e çështjes penale”, ka vendosur ndarjen e çështjes penale *** të vitit 2017, duke regjistruar këtë çështje me nr. *** e vitit 2017 dhe ***/** e vitit 2017.

3.1.2 Subjekti i rivlerësimit, më datë **.1.2022, ka përpiluar aktin “Kërkesë për pushimin e çështjes penale nr. ***/** të vitit 2017”. Gjykata së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastrë, me vendimin nr.***/**-2022-***, datë **.3.2022, ka vendosur: “Mospranimin e kërkesës për pushimin e çështjes dhe kthimin e akteve prokurorit për kryerjen e hetimeve të mëtejshme, lidhur me veprat penale ‘Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve’, parashikuar nga neni 190, prg. 1 dhe 3, të Kodit Penal dhe ‘Shpërdorimi i detyrës’, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal sipas drejtimeve të përcaktuara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi”.

3.2 Nga sa më lart, në gjendjen që janë aktet, rezulton se në hetimin e këtij procedimi penal të regjistruar më datë **.6.2019 dhe dërguar kërkesa për pushimin e procedimit penal më datë **.1.2022, subjekti i rivlerësimit ka kryer një sërë veprimesh hetimore, por duket se mbeten për t’u vlerësuar shkaqet eventuale që do të pretendohen edhe në këtë gjykim lidhur me një kohëzgjatje të tillë në rastin konkret.

4. Në lidhje me procedimin penal për veprën penale: “Pastrim i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, në ankimin e Komisionerit Publik, të datës 11.11.2021, është parashtruar nevoja e një hetimi të mëtejshëm lidhur me verifikimin e ecurisë së procedimit penal për kryerjen e veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit në drejtim të sekuestros së pasurisë dhe vendimmarrjes eventuale të Gjykatës, gjatë kontrollit të këtij vendimi, gjatë kryerjes së veprimeve hetimore.

4.1 Referuar akteve të administruara rezulton se subjekti i rivlerësimit, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit ***. ***, më datë **.11.2016, ka nxjerr urdhrin për regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Të pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal dhe shënimin në regjistër të emrave të personave nën hetim ***. ***, ***. ***, ***. ***, ***. ***, ***. ***, ***. ***, ***. ***, ***. ***, dhe ***. ***.

4.2 Gjatë hetimit të këtij procedimi, shtetasi ***. ***, viktimë e veprës penale “Mashtrimi”, ka paraqitur kërkesën për sekuestrimin e pasurisë nr. ***/**+*-**, ***. ***, ***, duke pretenduar se pasuria është produkt i veprës penale. Kjo kërkesë nuk është pranuar nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjes, si e pabazuar në ligj dhe në faktet që rezultojnë nga provat e marra gjatë hetimeve.

4.3 Ky vendim i prokurorit është ankimuar nga shtetasi ***. ***, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjyrokastër, e cila, me vendimin nr. ***/**-2019-**, datë **.1.2019, ka vendosur: “(i) Pranimin e kërkesës; (ii) Prishjen e vendimit të prokurorit për rrëzimin e kërkesës për vendosje sekuestro preventive; (iii) Urdhërimin e prokurorit të fillojë procedurën për vendosjen e sekuestros për pasurinë nr. ***/**+*-**, vol. **, faqe ***, ***. ***, ***, ***, ***, ndodhur në ***, Tiranë, duke ia komunikuar vendimin Zyrës së Regjistrimit së Pasurive të Paluajtshme Tiranë. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjyrokastër, me vendimin nr. **, datë **.2.2019, ka vendosur mospranimin e ankimit për shkak se prokurori, bazuar në nenin 418/1 të Kodit të Procedurës Penale, ka deklaruar heqjen dorë nga ankimi.

4.4 Subjekti i rivlerësimit, me kërkesën e datës **.2.2019, “Për vendosjen e sekuestros konservative”, i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjyrokastër, për të vendosur sekuestro konservative mbi pasurinë e paluajtshme *apartment banimi* me nr. ***/**+*-**, vol. **, faqe ***, ***. ***, ***, ***, ndodhur në ***, Tiranë, duke ia komunikuar vendimin Zyrës së Regjistrimit së Pasurive të Paluajtshme Tiranë. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjyrokastër, me vendimin nr. **, datë **.2.2019, ka vendosur pranimin e kërkesës, vendim i lënë nga Gjykata e Apelit Gjyrokastër me vendimin nr. **, datë **.4.2019.

4.5 Nga sa më lart, në gjendjen që janë aktet, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka regjistruar procedimin penal me nr. ***, i vitit 2016 për kryerjen e veprës penale “Pastrim i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal dhe vendimi për sekuestron preventive është marrë në zbatim të vendimit nr. **, datë **.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjyrokastër.

5. Lidhur me denoncimin e shtetasës *** ***, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, Komisioneri Publik ka parashtruar nevojën e hetimit të mëtejshëm në drejtim të verifikimit

nëse është subjekti i rivlerësimit, z. Juljan Çafka, prokurori i çështjes të procedimit penal nr. ***, datë **.3.2019, si dhe veprimet procedurale të kryera.

5.1 Referuar akteve të administruara lidhur me procedimin penal nr.*** të vitit 2019 rezulton se, në datën **.3.2019, është regjistruar procedimi penal për materialin kallëzues nr. **, datë ***.1.2019, të shtetases ***. ***, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, nga prokurori ***.***.

5.2 Subjekti i rivlerësimit, me aktin e datës **.5.2020, “Kërkesë për pushimin e çështjes penale nr. ***, të vitit 2019”, i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastrë, për pushimin e procedimit penal të regjistruar për veprën penale të “Falsifikimi i dokumenteve”. Referuar përmbajtjes së këtij akti rezultojnë disa veprime hetimore të kryera, si pyetja e personave që tregojnë rrethanat e hetimit, konkretisht shtetasit ***. ***, ***. ***, dhe ***. ***, administrimi në cilësinë e provave materiale të akteve nga ZVRPP Gjirokastrë, kontrata e shitblerjes me nr. *** rep., nr. ** kol., datë ***.2.2005, si dhe procesverbale ku janë marrë modele të shkrimit dhe nënshkrimit të shtetases ***. ***, dhe ***. ***, si dhe janë kryer ekspertimet grafike përkatëse.

5.2.1 Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastrë, me vendimin nr.**, datë ***.1.2021, ka vendosur mospranimin e kërkesës së prokurorit, prishjen e vendimit të pushimit dhe kthimin e çështjes për plotësim hetimesh, ku ndër të tjera, ka orientuar hetimin lidhur me: [...] *kryerje të ekspertimit nga një grup ekspertësh të IPSH Tiranë, pasi ekspertimet e marra nuk janë kategorike. Të thirren dhe të pyeten noteria ***. ***, dhe shtetasit ***. ***, dhe ***. ***, lidhur me ekzistencën e dy kontratave të ndryshme, por që kanë një numër repertori, koleksioni dhe datë, por mungojnë nënshkrimet dhe forma është e ndryshme [...].*

5.3 Subjekti i rivlerësimit, pasi ka kryer veprimet hetimore në zbatim të vendimit të gjykatës, me aktin e datës ***.7.2021, “Kërkesë për pushimin e çështjes penale nr.156, të vitit 2019”, i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, për pushimin e procedimit penal.

5.3.1 Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastrë, me vendimin nr. **, datë **.1.2022, ka vendosur kthimin e akteve të Prokurorisë, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda një afati prej dy muaj nga dita kur vendimi të marrë formë të prerë. Gjykata, midis të tjerash, ka orientuar hetimin lidhur me [...] *thirrjen e ekspertëve të IPSH Tiranë për të dhënë sqarime mbi aktin, si dhe pyetje të bëra nga përfaqësuesja ligjore e kallëzueses në këtë proces dhe analizë më e plotë e rolit të noteres në këtë proces [...].* Ky vendim është ankimuar nga ana e Prokurorisë në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, e cila, me vendimin nr. ***, datë **.5.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit penal nr. ***, datë **.1.2022.

5.4 Subjekti i rivlerësimit, sërish, pasi ka kryer veprimet hetimore në zbatim të vendimit të Gjykatës, me aktin e datës **.2.2023, “Kërkesë për pushimin e çështjes penale nr.***, të vitit 2019”, i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastrë, për pushimin e procedimit penal.

5.4.1 Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastrë, me vendimin nr.***, datë **.5.2023, ka vendosur sërish mospranimin e kërkesës së prokurorit dhe kthimin

e akteve për kryerjen e hetimeve të mëtejshme sipas përcaktimeve në pjesën arsyetuese të vendimit, ku kërkon nga organi i akuzës të procedohet me kërkimin e modeleve të lira të nënshkrimit të shtetasë ***. ***, modele të cilat, mundësisht, të jenë sa më të afërta në kohë me kohën e nënshkrimeve të pretenduara të falsifikuara.

5.5 Nga sa më lart, në gjendjen që janë aktet, rezulton se subjekti i rivlerësimit është prokurori që ka hetuar këtë procedim penal dhe veprimet e tij procedurale janë kryer në zbatim të vendimeve gjyqësore.

6. *Lidhur me denoncimin e shtetasë *** ***, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, Komisioneri Publik ka parashtruar nevojën në drejtim të verifikimit nëse subjekti i rivlerësimit ka kryer hetim të gjithanshëm e të plotë, në zbatim të detyrave të lëna nga gjykata.*

6.1 Referuar akteve të administruara lidhur me procedimin penal nr. ***, të vitit 2020, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në datën **.2.2020, ka regjistruar procedimin penal për materialin kallëzues nr.***, datë **.2.2020, me kallëzuese shtetasen ***. ***, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal dhe “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Shtetasja ***. ***, pretendon për falsifikim të vendimit nr. ***, datë **.9.1996, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Bashkia Gjirokastrë.

6.2 Subjekti i rivlerësimit, me aktin e datës **.11.2020, “*Kërkesë për pushimin e çështjes penale me nr. **, të vitit 2020*”, i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastrë, për pushimin e procedimit penal të regjistruar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal. Referuar përmbajtjes së këtij akti rezultojnë disa veprime hetimore të kryera në kuadër të këtij procedimi, si administrimi i akteve nga Agjencia e Trajtimit të Pronave dhe Drejtoria e Arkivave Shtetërore Vendore, administrim i një vendimi gjyqësor civil nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë, si dhe është marrë deklaram i shtetasë ***. ***.

6.2.1 Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastrë, me vendimin nr. ***, datë **.3.2021, ka vendosur mospranimin e kërkesës së prokurorit, kthimin e akteve prokurorit për të vazhduar hetimet, duke përcaktuar drejtimet e hetimit të lidhura me çdo kundërligjshmëri të mundshme në nxjerrjen e vendimit nr. ***, datë **.9.1996, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Bashkia Gjirokastrë, përdorimin e akteve të falsifikuara dhe të adresohet te Avokatura e Shtetit për fillimin e procedimit civil për kthimin e pronësisë shtetit.

6.3 Subjekti i rivlerësimit, pasi ka kryer veprimet hetimore në zbatim të vendimit të Gjykatës, me aktin e datës **.7.2021, “*Kërkesë për pushimin e çështjes penale nr. **, të vitit 2020*”, i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, për pushimin e procedimit penal.

6.3.1 Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. ***, datë **.10.2021, ka vendosur mospranimin e kërkesës së prokurorit, kthimin e akteve prokurorit për të vazhduar hetimet, duke përcaktuar drejtimet e hetimit lidhur me vërtetësinë e notës së transkriptimit, duke marrë modele krahasuese të kohës edhe pse akti nuk ndodhet

në origjinal, por vetëm kopje e vërtetuar, pasi, sipas arsytimit të vendimit në këtë rast, vërtetimi i kopjeve i jep atyre vlerën e origjinalitetit dhe, si të tilla, duhet të jenë objekt ekspertimi, verifikimit e notës së transkriptimit të vitit 1937 dhe shtetëzimit të vitit 1949. Ky vendim është ankimuar nga ana e Prokurorisë në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, e cila, me vendimin nr.***, datë **.4.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit penal nr. ***, datë **.10.2021.

6.4 Subjekti i rivlerësimit, pasi ka kryer veprimet hetimore në zbatim të vendimit të Gjykatës, me aktin e datës **.5.2023, “*Kërkesë për pushimin e çështjes penale nr. **, të vitit 2020*”, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë, për pushimin e procedimit penal.

6.4.1 Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastrë, me vendimin nr. ***, datë **.6.2023, ka vendosur mospranimin e kërkesës së prokurorit, kthimin e akteve prokurorit për të vazhduar hetimet, duke përcaktuar drejtimet e hetimit, pasi rezultoi se prokurori ka kryer vetëm ekspertim grafik të dokumentit, i cili ka rezultuar pa ndërhyrje dhe i punuar në origjinal, por se mbetet për t’u vërtetuar nëse ky dokument është prodhuar nga institucionet e kohës dhe punonjësit përkatës, duke i krahasuar karakteristikat e tij me dokumente të tjera të ngjashme të së njëjtës periudhë, si për sa i përket personave përpilues apo vërtetues të tij, ashtu edhe institucionit që e ka lëshuar, si dhe objekti i hetimit të jetë kontrata e qirasë e vitit 1949, që lidhet drejtpërdrejt me kohën e shtetëzimit të pronës.

6.5 Nga sa më lart, në gjendjen që janë aktet, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është prokurori që ka hetuar këtë procedim penal dhe veprimet e tij procedurale janë kryer në zbatim të vendimeve gjyqësore.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA